

## RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2002

### Hyrje

Në përgjithësi ky ishte viti më i rëndësishëm pas përfundimit të luftës, që do mund ta quanim si vit të konsolidimit dhe ecjes drejt normalitetit. Angazhimi i drejtpërdrejt i Ministrisë për Kulturë, respektivisht i dikasterit të saj- Departamentit të Kulturës, për t'u marrë me zhvillimin dhe përparimin e të gjitha bibliotekave rajonale, prandaj dhe të Bibliotekës Rajonale "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë, duke participuar në afatin e duhur buxhetin e një viti për financim të një sërë aktiviteteve dhe të konsumit të përgjithshëm që i shkojnë një institucioni, ne morëm frymë shumë më lirisht. Megjithatë mbetet shumë për t'u dëshiruar që të arrihet një shkallë më e lartë e zhvillimit dhe e përparimit të kësaj Biblioteke, duke shpresuar në rritje të përhershme të buxhetit, qoftë për pasurimin e fondit të koleksioneve, qoftë për veprimtari kulturore dhe aktivitete të tjera nga lëmi i bibliotekarisë. Kjo Bibliotekë është e vetmja e këtij tipi në kryeqytetin tonë dhe, përdoruesit e shumtë, që vijnë nga të gjitha shtresat e shoqërisë, kërkojnë shumë më tepër prej saj, e për t'u përmbushur kjo, kësaj i duhet përkrahje më e madhe dhe financim i pakursyer.

Ky vit do të mbahet mend edhe për hartimin e Ligjit për bibliotekat e Kosovës nga ekspertët që pritet të aprovohet në fillim të vitit 2003, e që pas kësaj ato do ta kenë më lehtë, sepse do të vendoset përfundimisht për statusin e tyre, veçmas për statusin e bibliotekave ndërkomunale (që na intereson më shumë) për të ditur saktësisht se a do të mbeten në kuadër të Ministrisë për Kulturë, apo në kuadër të komunave të veta? Por më e rëndësishme se kjo, është gjithë përmbajtja tjetër e këtij Ligji, që përcakton qartë funksionin, detyrat dhe përgjegjësitë e çdo biblioteke.

Gjatë këtij viti në shumë sektorë dhe degë u shënuan rezultate më të mira në realizimin e shërbimeve të planifikuara se në vitin paraprak, veçmas në disa sektorë dhe degë ku punohet me lexuesit, fakt që na kurajon se përdoruesit janë bërë dhe po bëhen për ditë e më shumë protagonistë të shpeshtë dhe të pandashëm të Bibliotekës dhe sallave të saj.

Kjo mund të thuhet edhe për disa trajnime të rëndësishme të punonjësve të Bibliotekës të organizuara përmes seminareve dhe për disa aktivitete kulturore dhe letrare të mbajtura në periudha të ndryshme gjatë vitit.

## *Veprimtaria dhe lloji i aktiviteteve*

Sado që synim i përhershëm i Bibliotekës është pasurimi dhe përtëritja e fondit të koleksioneve, për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe kërkesat e përdoruesve, ky vit ishte i suksesshëm edhe në punë të aktivitetit lidhur me librin dhe kulturën, në punë të profesionit, të renovimit dhe të pajisjes me inventar të ri, por edhe të projekteve të ndryshme. Këto suksese të Bibliotekës nuk mbetën pa u shënuar nga shumë mjete tona të informimit, duke njoftuar për to opinionin e gjerë të vendit dhe më larg.

### *I. Aktiviteti për punë profesionale*

Edhe në këtë vit synim yni ishte aftësimi i punonjësve të Bibliotekës në profesionin e bibliotekarisë. Dhe jo vetëm të kësaj Biblioteke. Për këtë flet më së miri organizimi i Seminarit njëmuor (25.3. – 7.5.2002) në këtë Bibliotekë, i financuar nga Departamenti për Kulturë dhe i organizuar nga ky Departament dhe kjo Bibliotekë, ku morën pjesë për trajnim 35 punonjës të 10 bibliotekave: 6 publike dhe 4 shkollore ( 3 të shkollave të mesme dhe 1 SHLP) të gjashtë komunave, që i takojnë rajonit të Prishtinës. Seminari ishte mjaft i suksesshëm, sepse shumica e pjesëmarrësve po mësonin për herë të parë për disa forma të punës profesionale në lëmin e bibliotekarisë: revizionin e librit, klasifikimin, katalogimin, sistemimin e skedarit dhe të koleksioneve të librit, por edhe përdorimin e kompjuterit, që shumë prej tyre po e zbatonin për herë të parë në praktikë.

Edhe në punë të klasifikimit, gjatë këtij Seminari, punonjësit e painformuar arritën të mësojnë për ndryshimet që ishin bërë më parë në disa grupe të KUD-it, veçmas në grupin e 8-shes, të gjuhësisë dhe të letërsisë.

Nga ky Seminar përfitoi edhe vetë kjo Bibliotekë (disa sektorë) dhe punonjësit e saj, pasi për herë të parë ajo po lirohej nga ekzemplari i tepërt dhe i papërdorshëm, duke u bartur në fondin rezervë: 19483 vëllime, por duke u kujdesur në ruajtjen e të gjithë titujve. Kjo punë lehtësoi edhe për një kohë vendosjen e librit të ri të ardhshëm, e që më parë nuk kishte mbetur hapësirë për këtë.

Me kërkesën e Ministrisë për Kulturë, nga ky fond rezervë, iu dhanë një sasi e mirë dy bibliotekave në lokalitetet serbe: 1550 copë apo 790 tituj bibliotekës në Plemetin dhe : 1509 copë apo 723 tituj bibliotekës në Ll. Sellë.

Përfitimi më i madh i punonjësve të kësaj Biblioteke, por edhe i të tjerëve, ishte mënyra e re dhe hera e parë që katalogimi i librit po bëhej me anë të kompjuterit. Pas kësaj, shumë shpejt, nga punonjësit e Sektorit të

përpunimit të librit u shtypën mijëra skedarë, disa qindra nga të cilët u printuan dhe u lëshuan në shfrytëzim, por kanë mbetur me shumicë të ruajtur nëpër disketa dhe kompjuterë, për shkak të mungesës së printerit adekuat për këso pune. Sekuenca të punës nga ky seminar u dhanë nëpërmes televizionit të RTK-së.

Në fund të janarit, për herë të parë, bëmë një anketë me shfrytëzuesit e degës në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve, kryesisht me studentë, për të kërkuar përgjigje në 16 pyetje: për kushtet e punës në këtë bibliotekë, për raportet në relacion me punonjësit e bibliotekës, për gjendjen e fondit të koleksioneve, për mungesën e llojit të literaturës sipas mendimit dhe konstatimit të tyre etj. Anketa u tregua e suksesshme, sepse patëm rastin të mësojmë gjëra të vlefshme nga të anketuarit.

U tregua mjaft e dobishme edhe mbajtja e takimeve gjatë muajit qershor dhe korrik e profesionistëve të kësaj Biblioteke me përfaqësuesit e subjektëve të kulturës në 5 komuna të rajonit të Prishtinës për njohjen më për së afërmi të problemeve dhe vështirësive në bibliotekat e tyre, në dhënien e udhëzimeve dhe sygjërimeve tona për trajtimin e adekuat krahas segmenteve të tjera të kulturës që i kushtojnë ata.

I një rëndësie të veçantë ishte mbajtja e kursit 3 javorë gjatë gjysmës së dytë të tetorit dhe javës së parë të nëntorit për punonjësit e bibliotekave të Kosovës, me kualifikim univerzitar, të organizuar nga BKU të Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Tiranës. E veçanta e këtij kursi ishte mbajtja e ligjëratave ekskluzivisht nga lektorët e Bibliotekës Kombëtare të Tiranës në disa segmente ndër më të rëndësishëm të bibliotekarisë, të cilët lanë mbresa të thella për njohjen prej ekspertësh të kësaj fushe të kulturës dhe për informacionin dhe ligjërimin e saktë dhe të çiltër.

Në maj të këtij viti ne bëmë edhe një punë të mirë që s'i kishte shkuar ndërmend dikujt më parë: në marrëveshje me personelin e Burgut të Prishtinës, ne shprehëm gatishmërinë tonë që t'iu dërgojmë librat e Bibliotekës për t'i lexuar të burgosurit. Dhe pas angazhimit të punonjësve tanë, ne përgatitëm listat dhe u dërguam mbi 150 libra në gjuhë të ndryshme që i kishin kërkuar vetë të burgosurit. Dhe ne do të vazhdonim edhe më tej këtë formë të bashkëpunimit, sikur ata të kishin kushte për ta mundësuar një gjë të tillë.

## ***II. Aktivitetet kulturore***

Edhe gjatë këtij viti u shënuan disa aktivitete të rëndësishme kulturore. Siç është bërë tashmë edhe traditë, në gjysmën e janarit u dhanë shpërblimet për dy lexuesit më të mirë të vitit 2001 dhe u shpallën gjithashtu dy librat më

të lexuar të po atij viti. Ky shpërblim u takoi nxënësit të klasës VIII, Krenar Dobroshi dhe studentit të Gjuhës dhe letërsisë, Muhamet Çitaku, të cilët u shpërblyen me nga një komplet librash, kurse veprat më të lexuara u shpallën “Lushi si askushi” i Arif Demollit dhe “Jeta e një maturanti” e Xhemil Dodes. Ndarja e shpërblimeve u bë në mënyrë solemne dhe nën prezencën e mediave.

Në bashkëpunim me shkollën fillore “Gjergj Fishta”, në sallën e “Bibliotekës përkujtimore” u shënuar 7 Marsi-Dita e Mësuesit, me ç’rast u dha një program kulturo-letrar nga nxënësit. Punimet më të mira: 3 nga krijimet letrare dhe 3 nga arti figurativ, të vlerësuara nga dy juri, u shpërblyen me libra dhe komplete ngjyrash me penë e fletore. Edhe ky takim u xhirua nga mediat elektronike dhe u shënuar në shtypin e përditshëm.

Ngjarje e rralë për t’u shënuar dhe që bëri jehonë, ishte mbajtja e 50 vjetorit të krijimtarisë së shkrimtarit Rifat Kukaj, që u organizua në fillim të qershorit, në bashkëpunim me Bibliotekën dhe Karvanin e Shkrimtarëve. Në këtë rast shkrimtari u shpërblye me të holla: 500 € nga Karvani... dhe 350 € nga Departamenti i Kulturës, në emër të të cilit ia dorëzoi drejtori i Bibliotekës. Këtë ngjarje e shënuan shumica e medimeve, elektronike dhe të shtypit.

Në gjysmën e dytë të majit Biblioteka mori pjesë me një ekspozitë në Panairin e librit që u organizua në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë për tri ditë me radhë dhe mund të themi se zgjedhja e ekzemplarëve të rrallë dhe të panjohur për shumicën e publikut, zgjoi kërkshërinë dhe interesimin për literaturën e Bibliotekës, që ishte dhe qëllim yni për pjesëmarrje.

Pas shpalljes së binjakëzimit midis kësaj Biblioteke dhe Bibliotekës publike të Durrësit në dhjetor të vitit 2001 në Prishtinë, në qershor të 2002 qe ftuar një delegacion i Bibliotekës prej 4 vetash nga Biblioteka e Durrësit, për të marrë pjesë në hapjen e një ekspozite të librit, për të shkëmbyer përvojat midis dy bibliotekave, për të parë si funksionon libërbusi I asaj Biblioteke dhe për të vizituar disa monumente kulturore. Pritja ishte shumë e përzemërt dhe vizita mjaft e suksesshme, kurse abonimi ishte rregulluar nga vetë drjetoria e Bibliotekës së Durrësit.

Hapja e ekspozitës së librit, më 20.11.2002, në Sallën e leximit për të rritur, me titull “ Titujt e librit të Bibliotekës 2001/2002” ishte e përgatitur profesionalisht dhe teknikisht mjaft mirë, gjë që u bëri përshtypje të të gjithë të ftuarve. Ajo u la e hapur dy ditë dhe pati vizitorë të shumtë, sidomos nxënës. Kjo ekspozitë u bë e njohur për opinionin e gjerë përmes mediave të ndryshme.

Aktiviteti kulturor u mbyll për këtë vit në takimin e organizuar në degën “Përrallat” me shkrimtarin Xhevat Sylja, të cilin e shoqëronin shkrimtarët Arif Demolli dhe Zejnulla Halili.

### ***III. Renovimet dhe pajisja me inventar***

As në gjatë këtij viti nuk munguan përpjekjet për ndonjë renovim dhe përtëritje të inventarit. Dega e “Lekturës” përfitoi nga të dyja këto: iu bë lyerja e merituar, u pajis me një garniturë tavolinash dhe karrigash për lexuesit, u shtrua me tepison dhe u riparua sistemi i ngrohjes, që ishte në defekt më shumë se 15 vjet, njësoj si edhe në degën “Përrallat” që gjendet pranë saj.

Një renovim i mirë iu bë edhe degës në Bardhosh, me rastin e renovimit të objektit të qeverisë lokale, në kuadër të të cilit gjendet kjo bibliotekë. Para kësaj, kjo ishte dega me kushte më të papërshtatshme për punë. Punimet në këtë objekt i financoi Kuvendi Komunal.

Salla e leximit për të rritur në Bibliotekën qendrore u mbulua e tëra me tepison dhe u blenë 10 karriga për lexuesit që të shfrytëzohen për pushim në oborrin e Bibliotekës.

Gjatë mbajtjes së Seminarit njëmuor, punëtorëve të kyçur në këto punë, iu blenë mantela të përshtatshëm.

### ***IV. Pasurimi dhe përtëritja e koleksioneve dhe e periodikut***

Në krahasim me vitin e kaluar, kemi një rënie drastike në drejtim të pasurimit të koleksioneve të Bibliotekës. Janë marrë vetëm 2489 libra apo 457 tituj dhe prej tyre me të blerë 1582 dhe me të falur 907 copë. Nga ata që kanë falur libra, 32 janë individë dhe 13 janë botues dhe OJQ. Departamenti i Kulturës nuk pati vepruar aspak mirë, kur mori qëndrim dhe e reduktoi buxhetin e dedikuar për libra, nga 6000 € vetëm në 3500 €! Të shtojmë dhe këtë, se një sasi e librit të blerë vie nga vetë kursimet e Bibliotekës, me mjetet e realizuara nga *anëtarësimi i lexuesve*?

Në punë të periodikut çështja qëndron pak më mirë. Në Bibliotekën qendrore për çdo ditë merren 4 gazeta të përditshme, ndër më të kërkuarat, dhe lexohen mjaft nga përdoruesit e Bibliotekës, e që shfrytëzohen në sallën e leximit. Tri nga këto: “Zëri”, “Koha Ditore” dhe “Epoka e re” na janë mundësuar falas nga redaksitë e tyre, kurse gazetën “Bota sot” jemi të detyruar ta paguajmë.

Prej revistave marrim vetëm “Zërin” dhe nuk e paguajmë. “Zëri” ditor dhe javor dhe “Koha Ditore” merren edhe në degën e Pallatit të Rinisë dhe nuk paguajmë.

Me vështirësi i sigurojmë disa nga revistat për fëmijë që dalin tek ne, pasi ato nuk gjenden në shitje, por u dërgohen shkollave. Kështu përdodh me revistën “Pionieri”, por edhe me ndonjë tjetër.

Gazeta “Rilindja” është e lidhur dhe e ruajtur, me një ndërprerje në periudhën 1963/1977, gjersa nuk ka pushuar së botuari që ka afër dy vjet. Janë lidhur edhe gazetat “Bota sot”, “Koha ditore” dhe “Zëri” për 5 muajt e parë të vitit.

### ***Të dhëna të veçanta për të gjithë sektorët dhe degët***

Biblioteka është e organizuar sipas sektorëve (brenda) dhe degëve (jashtë). Në Bibliotekë funksionojnë **këta sektorë**: 1. Sektori i Pranimiit dhe Përpunimit të librit, 2. Sektori i Bibliotekës për fëmijë, 3. Sektori i Bibliotekës për të rritur, 4. Sektori i Sallës së leximit dhe Periodikut, 5. Sektori i ruajtjes së trashëgimisë (i vendit) dhe 6. Sektori i punëve të përbashkëta. **Degët**: 1. Biblioteka Përkujtimore (për fëmijë), 2. „Përrallat“, 3. Biblioteka në Pallatin e Rinisë, 4. „Lektura“ (në qytet), 5. dega në Llukar, 6. në Koliq, 7. në Bardhosh (Jugoviç), 8. në Hajvali dhe 9. në Slivovë (në fshatra).

**Sqarim**: më parë ka ekzistuar edhe Sektori i Zhvillimit dhe Përparimit bibliotekar, por për mungesë të kuadrit nuk vepron më, por punët e tij i mbulon drejtori i Bibliotekës me ndihmën e punëtoreve të Sektorit të Përpunimit të librit. Është koha e fundit që të sigurohet ky kuadër dhe të fillojë punën edhe ky sektor me shumë rëndësi.

### ***Sektori i Pranimiit dhe Përpunimit të librit***

Ky sektor u angazhua që gjithë librat e hyrë t’i përpunojë sipas standardeve të preferuara: përpunimin fizik, klasifikimin, inventarizimin dhe katalogimin e librit, pastaj lekturimin e skedarit, sistemimin e skedarit në katalogun qendror dhe shpërndarjen nëpër sektorë dhe degë të Bibliotekës për shfrytëzim nga lexuesit. Në mars të këtij viti u mbajt një seminar i organizuar nga zyrtari për Biblioteka i Ministrisë së Kulturës ku morën pjesë një numër i madh punëtorësh nga biblioteka jonë, bibliotekat Rajonale dhe ato shkollore. Për herë të parë në këtë seminar katalogimi dhe printimi i skedarëve nisi të bëhet me anë të kompjuterit. Punëtorët nga ky sektor e bënë mbikqyrjen e ecurisë së punës dhe arkivimin e materialit. Me përvojën

e tyre profesionale ndikuan në ngritjen e profesionalizmit tek të tjerët. Gjithashtu në tetor të këtij viti punëtorët e këtij sektori morën pjesë në një seminar 13 ditor të organizuar nga B.K. e Kosovës me lektorë nga B.K. e Tiranës. Disa nga risitë dhe përvojat që u morën nga ky seminar nisën të aplikohen edhe në bibliotekën tonë.

Përveç kësaj, janë angazhuar dhe kanë bërë një punë të vlefshme edhe nëpër disa sektorë të tjerë dhe degë të Bibliotekës: përgatitja e librave për ekspozitë, trajnimi i puëtorëve, heqja e skedave udhëzuese, përpilimi i projekteve etj. Edhe pse të gjitha materialet që kanë hyrë në bibliotekë gjatë këtij viti janë përpunuar, vërehet një rënie e shifrave si pasojë e mosfurnizimit me tituj të ri.

### **Treguesi i shërbimeve**

Përpunimi fizik	3580 vëllime
Klasifikimi	2608 vëllime
Inventarizimi	3710 vëllime
Çregjistrimi	2299 vëllime
Kompenzimi	28 vëllime
Katalogizimi	1235 vëllime
Skedarë të shkruar	1037 njësi
Skedarë të shtypur	10323 njësi
Skedarë të lekturuar	6411 njësi
Skedarë të sistemuar	3226 njësi

### **Sasia e librit të përpunuar sipas KUD-it**

<b>0</b>	<b>329 vëllime</b>
<b>1</b>	<b>15 vëllime</b>
<b>2</b>	<b>92 vëllime</b>
<b>3</b>	<b>304 vëllime</b>
<b>4</b>	
<b>5</b>	<b>47 vëllime</b>
<b>6</b>	<b>22 vëllime</b>
<b>7</b>	<b>14 vëllime</b>
<b>8</b>	<b>2641 vëllime</b>
<b>9</b>	<b>204 vëllime</b>

### *Shpërndarja e librit sipas sektorëve dhe degëve*

1. Sektori i Bibliotekës për fëmijë	428	vëllime
2. Sektori i Bibliotekës për të rritur	558	vëllime
3. Sektori i Sallës së leximit dhe Periodikut	134	vëllime
4. Sektori i Bibliotekës së Vëndit	983	vëllime
5. dega në Pallatin e Rinisë	276	vëllime
6. dega „Lektura“	200	vëllime
7. dega Biblioteka Përkujtimore	234	vëllime
8. dega „Përrallat“	85	vëllime
9. dega në Hajvali	117	vëllime
10. dega në Llukar	122	vëllime
11. dega në Koliq	82	vëllime
12. dega në Slivovë	101	vëllime
13. dega në Bardhosh	125	vëllime
<b>gjithsej</b>	<b>3445</b>	<b>vëllime</b>

### *Sektori i Bibliotekës për fëmijë*

Ky sektor i rëndësishëm i Bibliotekës në këtë vit pati një rënie të indeksit të anëtarëve të regjistruar për 29 më pak se në vitin paraprak. Këtu mbase mund të ketë ndikuar rritja e çmimit të anëtarësisë, por edhe mungesa e literaturës së kërkuar nga lexuesit e vegjël dhe të rinj. Por kjo nuk mund të thuhet edhe për sasinë e librave të lexuar, ku ky indeks është më i madh për 429 libra të lexuar se në vitin e kaluar, që do të thotë se është kryer një seleksionim pozitiv i të regjistruarve. Gjatë seminarit janë hequr ekzemplarët e tepërt nga fondi në gj. serbe dhe është bërë numërimi i titujve dhe ekzemplarëve.

Puna me kompjuter në këtë sektor ka gjetur një përdorim të kënaqshëm.

### **Treguesi i shërbimeve**

Anëtarë të regjistruar	571
Libra të lexuar	8081
Periodiku	84
Sistemimi i skedarit	316
Shfrytëzuesit e sallës së lex.	314



### ***Sektori i Bibliotekës për të rritur***

Punëtorët e këtij sektori janë angazhuar për t'i shërbyer anëtarët e Bibliotekës në shfrytëzimin e literaturës që ata kanë kërkuar, në sistemimin e fondit të koleksioneve, në sistemimin e skedarëve, është kompletuar skedari sistematik (profesional). Gjithashtu gjatë këtij viti në këtë sektor është bërë heqja e ekzemplarëve të tepët nga fondi i librave në gj. serbe.

Në krahasim me vitin e kaluar në këtë sektor ka një rritje të indeksit të anëtarëve të regjistruar për 83 më shumë. Edhe këtu, si në Sektorin e Bibliotekës së fëmijëve, shifra e librave të lexuar është më e madhe për 265 se ajo e vitit të kaluar. Edhe më në këtë Sektor pengesë kryesore për të pasur më shumë lexues, është mungesa e literaturës, veçmas në gjuhën shqipe.

#### **Treguesi i shërbimeve**

Anëtarë të regjistruar	367
Libra të lexuar	6994
Sistemimi i skedarëve	2517

### ***Sektori i Sallës së leximit dhe Periodikut***

Punëtorët në këtë sektor u përpoqën që t'i shërbejnë shfrytëzuesit e sallës me literaturë që atyre u nevojitej dhe me gazetatat e revistat që disponon Biblioteka. Përmirësimi i kushteve pas renovimit të sallës së leximit këtë vit ka ndikuar në rritjen e numrit të anëtarëve të regjistruar për 101 dhe shfrytëzuesve të kësaj sale për 2003. Edhe treguesi i librave të lexuar është rritur për tri herë më shumë dhe do të ishte sigurisht më i madh, sikur edhe këtij sektori të mos i mungonte literatura e kërkuar, sidomos ajo e teksteve univerzitare që studentët e kërkojnë aq shumë. Ndonëse nga pak u shfrytëzuan gati të gjitha grupet sipas KUD-it, edhe këtu dominoi letërsia dhe gjuhësia. Skedari i përgatitur nga Sektori i Përpunimit të librit u sistemua në të dy katalogët: alfabetik dhe sistematik. Gazetat, pas përfundimit të çdo muaji, u sistemuan dhe u vendosën në vend të caktuar.

#### **Treguesi i shërbimeve**

Anëtarë të regjistruar	236
Libra të lexuar	4352

Periodiku	19730
Gazeta	17146
Revista	2584
Sistemimi i skedarit	691
Shfrytëzues të sallës së lex.	6462

### ***Dega „Biblioteka Përkujtimore“***

Këtë degë të Bibliotekës edhe këtë vit e përcollën disa vështirësi, veçmas moszgjidhja e problemit të ngrohjes së objektit. Kjo është bërë pengesë serioze për të realizuar më shumë punë dhe aktivitete, sidomos ato të kulturës. Gati për gjysmë viti salla e destinuar për këso punësh nuk ka mundësi të shfrytëzohet, kurse tkurrja e punës vetëm në një sallë, ka ndikuar dukshëm në mosrealizimin e shërbimeve të planifikuara. Këtë vit numri i anëtarëve të regjistruar është vetëm për 19 më shumë se vitin e kaluar. Numri i librave të lexuara është 5020. Gjatë këtij viti është organizuar 50 vjetori i krijimit të Rifat Kukajt dhe një manifestim për nder të ditës së mësuesit në bashkëpunim me nxënësit e sh. f. “Gjergj Fishta”, të cilët u paraqitën me punimet e tyre artistike. U ndanë edhe shpërblime për punimet më të mira.

### **Treguesi i shërbimeve**

Anëtarë të regjistruar	369
Libra të lexuar	5020
Komentim i librave të lex. nga lexuesit	302
Vizatime	915
Ilustrime	685
Punime me dorë	24
Punë me kompjuter	969
Ekspozitë nga krijimet e fëmijëve	7
Revista të lexuara	477
Shfrytëzues të sallës së lex.	8013

### ***Dega „Përrallat“***

Kjo degë e Bibliotekës vazhdon të jetë tërheqëse për të vegjëlit gjithnjë e më shumë, qoftë për kushtet që afrojnë ajo, qoftë për format e larmishme të punës dhe aktiviteteve që kryhen në të. Vizitorët e shumtë që vijnë herë pas

herë, nuk mund të mos e thonë se janë të rralla bibliotekat si kjo që u afrojnë të vegjëlve kënaqësi, argëtim dhe pajisje me dituri dhe shkathtësi. Gjatë këtij vit u organizua takimi me shkrimtarin për fëmijë Xhevat Syla, ekspozita të punuara nga fëmijët etj.

Në këtë degë të Bibliotekës ,këtë vit janë regjistruar 292 anëtarë, do të thotë 32 më shumë se vitin e kaluar. Ndërsa numri i librave të lexuara është për 2743 më shumë se vjet.

### ***Treguesi i shërbimeve***

Anëtarë të regjistruar	292
Libra të lexuar	9089
Komentim nga fëmijët	3888
Komentim nga librarët	1441
Vizatime	3249
Ilustrime	663
Punime dore	285
Demonstrim lojrash me kompjuterë	866
Demonstrim me aparate audio-vizuele	130
Ekspozita pikturash-vizatimesh	3
Gazeta të lexuara	
Revista të lexuara	3398
Takime me shkrimtarë	1
Shfrytëzues të sallës	17102

### ***Dega „Lektura“***

Ndonëse me një fond modest librash, ajo ishte e frekuentuar mjaft mirë. Dihet që kjo degë punon vetëm në një ndërrim dhe vetëm me një punëtor. Edhe këtë vit ka rënë numri i anëtarëve të regjistruar për 23, gjithashtu numri i librave të lexuara ka një rënie të vogël.

### ***Treguesi i shërbimeve***

Anëtarë të regjistruar	251
Libra të lexuar	3595
Shfrytëzues të sallës	514

### ***Dega në Pallatin e Rinisë***

Numri i shfrytëzuesve të kësaj dege është rritur mbi parashikimin tonë , 150 anëtarë më shumë se në vitin praparak. Kurse numri i librave të lexuara është për 3621 më shumë. Kushtet e mira që mundëson salla e kësaj biblioteke, madje më të mira se në vetë Bibliotekën Kombëtare, ka bërë që rritja e interesimit të shfrytëzuesve të jetë e lartë. Por siç ndodh me shumicën e bibliotekave, sallat e leximit shfrytëzohen kryesisht nga studentët dhe ata të shumtët janë lexues pasivë të bibliotekës, sepse shërbehen kryesisht me literaturë të tyre. Kjo ka ndodhur edhe me këtë degë, pasi Biblioteka nuk ishte në gjendje të sigurojë atë lloj literature që do të krijonte më shumë shërbime. Është bërë punë e mirë edhe në plotësimin dhe sistemimin e skedarit të librit nga punonjësit e Sektorit të Përpunimit të librit, si dhe përmirësimi i fondit të koleksioneve në çështjen e sistemimit sipas KUD-it.

### ***Treguesi i shërbimeve***

Anëtarë të regjistruar	811
Libra të lexuar	9489
Gazeta të lexuara	920
Revista të lexuara	118
Shfrytëzues të sallës	1836

### ***Dega në Llukar***

Përkundër asaj se kjo degë është shumë afër me shkollën e këtij fshati dhe është nga degët më të pasura me libra, me kushte të mira për punë, numri i shfrytëzuesve është fare modest. Këtë vit vërehet një rritje më e madhe e interesimit të nxënësve dhe të rinjve të këtij fshati për 69 më shumë se vitin e kaluar. Një ngritje ka pësuar edhe numri i librave të lexuara. Numri i anëtarëve është 222, kurse i librave të lexuara 3321. Shfrytëzues të sallës janë 346.

### ***Dega në Koliq***

Punëtori i kësaj dege të bibliotekës , përkundër këmbënguljes dhe vërejtjeve tona , për këtë vit nuk e ka sjellë raportin e punës. Punëtori, për shkaqe shëndetësore, nuk ka përgjrgjësi në punë.

### ***Dega në Bardhosh***

Kjo degë ka një fond modest të librit. dhe punon në lokal krejt të papërshtatshëm për punë të bibliotekës. Numri i lexuesve, krahasuar me numrin e nxënësve të shkollës dhe banorëve të fshatit, është fare i vogël. Rritja e numrit të anëtarëve të regjistruar në krahasim me vitin tjetër është e vogël, vetëm 13 më shumë. As këtu nuk ndikuar qëndrimi ynë për regjistrim falas të atyre që nuk i kanë kushtet. Pra janë regjistruar 161 anëtarë, kryesisht nxënës, të cilët i kanë lexuar 1925, 198 revista.

### ***Dega në Hajvali***

Gjendet afër shkollës më të madhe me nxënës se të shumë fshatrave të tjerë. Por sjellja e kësaj shkolle ndaj kësaj biblioteke është e përçudnuar dhe për kritikë, e këtë e kemi thënë në një rast edhe publikisht...Udhëzimi ynë për mënyrën e rritjes së numrit të anëtarëve, duke ju mundësuar regjistrimin falas, këtu ka ndikuar mjaft mirë. Numri i anëtarëve të regjistruar këtë vit ka rënë për 35 në krahasim me vitin 2001. Në vitin 2002 janë regjistruar 220 lexues, ndërsa janë lexuar 8179 libra.

### ***Dega në Slivovë***

As në këtë degë nuk ka interesim për bibliotekën. Ndonëse anëtarë të kësaj biblioteke janë vtëm nxënësit dhe ata që vijnë në shkollë nuk janë më shumë se 100, është dashur që ky numër të përfshihet i tëri në anëtarësim, pasi edhe këtu është lejuar regjistrimi falas. Këtë vit janë të regjistruar 59 lexues, 1 më shumë se vitin paraprak, por vërehet një rritje e konsiderueshme e numrit të librave të lexuara, 2779. Shfrytëzues të sallë janë 422.

### ***Sektori i punëve të përbashkëta***

Punët që kreu ky sektor janë ndër më të ndryshmet. Janë evidentuar të gjitha hyrje-daljet e mjeteve materiale, si nga anëtarësimi i lexuesve, ashtu edhe mjeteve të ndara nga Ministria e Kulturës. U bë kalkulimi dhe regjistrimi i të gjitha faturave dalëse të këtyre mjeteve. Janë evidentuar dhe sistemuar të gjitha dokumentet zyrtare. Është bërë furnizimi i të gjithë sektorëve dhe degëve me material bibliotekar.

Është intervenuar në raste të ndryshme për riparimin e defekteve të paraqitura dhe kujdesur për mirëmbajtjen e objektit të vjetëruar në të gjitha degët.

Ky sektor është kujdesur edhe për mbarëvajtjen e punës dhe për përgjegjësinë në punë, e sidomos gjatë kohës kur drejtori ishte në pushim mjekësor.

Sektori i punëve të përbashkëta është kujdesur dhe ka mbikqyrë edhe punën e pastrimit të objektit të bibliotekës dhe të degëve të saj. Sipas vlerësimit të bërë, pastrimi ka qenë në nivel të kënaqshëm. Në të ardhmen do të bëhen përpjekje që pastrimi të jetë në nivel më të lartë.

### ***Bashkëpunimi***

Bashkëpunimi i Bibliotekës ishte i ngushtë me Bibliotekën Kombëtare dhe Univerzitare, dhe me biblioteka të tjera të vendit, e në rend të parë me ato të Bibliotekës Rajonale të Prishtinës, ku përfshihen bibliotekat e pesë qendrave: të Besianës, Fushë Kosovës, Kastriotit, Drenasit dhe Lypianit. Kontaktet me këto biblioteka ishin të herëpashershme dhe u ndihmuan me libra, me material bibliotekar, me instruksione profesionale, madje edhe drejtpërdrejt me angazhim të punonjësve tanë në rregullimin e bibliotekave të tyre. Një ekip i Sektorit të Përpunimit të librit punoi dy javë rresht në bibliotekën e Fushë Kosovës, duke e ndihmuar në klasifikimin e librit, revizionin dhe sistemimin e fondit të koleksioneve. Në mars të këtij viti, përfaqësuesit e bibliotekave rajonale dhe ato të shkollave morën pjesë në seminarit 30 ditor të organizuar në bibliotekën tonë ku përfituan një përvojë shumë të madhe si në klasifikimin e materialeve ashtu edhe në katalogimin dhe sistemimin e fondeve të librit. Këtë vit ka munguar bashkëpunimi me Shoqatën e Bibliotekarëve të Kosovës.

***Prishtinë, 21.01.2002***

***Sylejman Pireva, drejtor***